



PRESIDENCA SHQIPTARE E KS: SHQIPËRIA KRAH PËR KRAHDHE ME UKRAINËN

Në kuadër të Javës së Nivelit të Lartë të OKB dhe Presidencës shqiptare të Këshillit të Sigurimit, Kryeministri Edi Rama drejtoi Debatin e Hapur të Nivelit të Lartë të KS mbi Ukrainën. Kryeministri Rama theksoi se e drejta e vetos e ka dobësuar fuqinë e Këshillit të Sigurimit, teksa i bëri thirrje shteteve anëtare të OKB që të jenë më të qartë lidhur me rastin e agresionit në Ukrainë.



MINISTRI HASANI: 'ALEANCA HUMANITARE E SEKTORIT PRIVAT' E DOMOSDOSHME PËR MENAXHIMIN E KRIZAVE HUMANITARE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, kryesoi Debatin e Hapur të Nivelit të Lartë të Këshillit të Sigurimit të OKB me temë “Nxitja e Partneritetit Publik-Privat në trajtimin e çështjeve humanitare”, ku prezantoi nismën e Shqipërisë për krijimin e Aleancës Humanitare të Sektorit Privat, e cila sipas tij do të mobilizojë burimet në mënyrë efektive me qëllim që ndihma e nevojshme të rrjedhë përmes mekanizmave ekzistuese të këtyre sektorëve.



MINISTRI HASANI DREJTON TAKIMIN E KS: LIGA ARABE ROL KYÇ NË ZBUTJEN E TENSIONEVE NË TERREN

MEPJ Igli Hasani, në cilësinë e Presidentit të Këshillit të Sigurimit drejtoi takimin e Dialogut Interaktiv Informal me vendet e Ligës Arabe (IID – LAS). Ministri Hasani u shpreh se Shqipëria mbështet rolin e Lidhjes së Shteteve Arabe në zbutjen e tensioneve, teksa ritheksoi nevojën për shtensionimin dhe tërheqjen nga hapat e njëanshëm në terren.



MINISTRI HASANI KRYESON TAKIMIN E KS: MBËSHTESIM MARRËVESHJEN E ARMËPUSHIMIT ARMENI-AZERBAJXHAN

MEPJ Igli Hasani në cilësinë e Presidentit të Këshillit të Sigurimit, kryesoi takimin “Armeni – Azerbajxhan” në të cilën u trajtua përshkallëzimi i fundit ushtarak në rajonin e Nagorno-Karabakut. Ministri Hasani i bëri thirrje të dyja palëve të qëndrojnë të përkushtuara ndaj marrëveshjes së arritur për të ndaluar veprimet ushtarake dhe të shmangin çdo përshkallëzim të mëtejshëm. Në kuadër të Javës së Nivelit të Lartë të OKB, kryediplomati shqiptar zhvilloi edhe disa takime të rëndësishme dypalëshe dhe shumëpalëshe.



HYN NË FUQI MARRËVESHJA SHQIPËRI-ZVICËR PËR SIGURIMET SHOQËRORE

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme bën me dije se, duke filluar nga data 01 tetor 2023, hyn në fuqi Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Zvicrës. Kjo marrëveshje do t'u ofrojë qytetarëve të të dy vendeve të drejtën të gëzojnë përfitimet e plota të kontributeve të tyre.